

VENDIM
Nr. 121, datë 6.5.2026

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ELENERGJI” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 964/7 prot., datë 5.5.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Elenergji’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “Elenergji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2725 prot., datë 27.10.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtica 1”, me kapacitet të instaluar 5,226 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushticë, në qarkun e Elbasanit.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 284, datë 6.11.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 8.11.2025 dhe 10.11.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 9.12.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2725/4 prot., datë 20.11.2025. Nga MIE nuk ka pasur ndonjë qëndrim, në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë.

- Me shkresën nr. 2725/3 prot., datë 14.11.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë dhe pasi ka rezultuar se ka ende dokumentacion që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim, ndaj Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 340, datë 23.12.2025, vendosi të pezullojë procedurën e licencimit të shoqërisë “Elenergji” sh.p.k., deri në depozitimin e dokumentacionit të munguar të aplikimit.

- Ky vendim iu njoftuan shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE-s me nr. 2725/9 prot., datë 29.12.2025.

- Më pas, nëpërmjet *email*-it të datës 24.3.2026 dhe shkresës të protokolluar në ERE me nr. 964/1 prot., datë 26.3.2026, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion/informacion plotësues për aplikimin.

- Me depozitimin e dokumentacionit përkatës nga shoqëria brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Bordit nr. 340/2025, u vlerësua se ka rënë kushti i pezullimit, e si e tillë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 92, datë 2.4.2026, vendosi të heqë pezullimin e vendosur dhe të zgjasë afatin e vendimmarrjes përfundimtare për aplikimin e shoqërisë “Elenergji” sh.p.k., me qëllim zhvillimin e një komunikimi me shoqërinë, në lidhje me dokumentacionin/informacionin, që ka ende nevojë për plotësime.

- Shoqëria, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 964/4 prot., datë 22.4.2026 dhe nr. 964/6 prot., datë 29.4.2026, ka depozituar informacionin/dokumentacionin plotësues të kërkuar.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Shoqëria është pajisur me kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim-operim-transferim) “Për ndërtimin e hidrocentralit ‘Bushtrica 1’”, nr. 2025 rep., nr. 925/1 kol., datë 18.9.2017, nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe subjektit për qëllime të veçanta “Elenergji” sh.p.k., ndryshuar me amendim kontrate nr. 1643 rep., nr. 1045/2 kol., datë 23.7.2018, kontratë shtesë koncesionit për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim-operim-transferim) “Për ndërtimin e hidrocentralit ‘Bushtrica 1’”, nr. 34 rep., nr. 26 kol., datë 6.1.2022 dhe me kontratë shtesë koncesionit për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim-operim-transferim) “Për ndërtimin e hidrocentralit ‘Bushtrica 1’”, nr. 382 rep., nr. 146 kol., datë 17.1.2025.

- Shoqëria ka nënshkruar me “OST” sh.a. “Marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit”, protokolluar në “OST” sh.a. me nr. 5877 prot., datës 15.8.2018, amenduar me amendimin nr. 1, protokolluar në “OST” sh.a. me nr. 3100/7 prot., më 28.7.2025.

- Shoqëria është pajisur me lejen për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor me nr. 395 prot., datë 31.5.2022, me nr. serial 000062, e lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU) Shkumbin, miratuar me vendimin nr. 3, datë 24.5.2022, të Këshillit të Basenit Ujor Shkumbin. Kjo leje është e vlefshme sipas kontratës së koncesionit.

- Shoqëria është pajisur me deklaratë mjedisore nr. AN110120240005, datë 25.3.2024, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për personin juridik “Elenergji” sh.p.k., për të zhvilluar projektin: “HEC Bushtrica 1”, me kapacitet të instaluar 5,226 kw.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- Shoqëria ka deklaruar se do të vendosë në punë hidrocentralin brenda datës 13.1.2027, afat ky brenda afatit të vlefshmërisë së përcaktuar në nenin 10.2 të kontratës së koncesionit nr. 2025 rep., nr. 925/1 kol., datë 18.9.2017, ndryshuar me kontratën shtesë nr. 382 rep., nr. 146 kol., datë 13.1.2025. Në këto rrethana, vlerësohet të përcaktohet që shoqëria duhet të fillojë operimin brenda datës 13.1.2027.

- Po ashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 11, të kontratës nr. 2025 rep., nr. 925/1 kol., datë 18.9.2017, vlerësohet që t’i lihet detyrë shoqërisë që, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fillimi i operimit/ushtimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për komisionimin dhe vënien në punë të veprës. Brenda këtij afati vlerësohet që t’i lihet asaj detyrë që të përditësojë në ERE dhe informacionin përkatës për strukturën organizative.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Elenergji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 1”, me kapacitet të instaluar 5,226 kw, me vendndodhje në

pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë në qarkun e Elbasanit, me afat vlefshmërie të licencës deri më 18.9.2052.

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 13.1.2027.

3. Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fillimi i operimit/ushtimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE komisionimin dhe vënien në punë të veprës, si dhe të përditësojë informacionin mbi strukturën organizative të saj.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të plotësimit/mosplotësimit nga shoqëria të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3, si dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Elenergji” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OST” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti